



NË KËTË NUMËR

- MBAHET MBLEDHJA E 11-TË E RRJETIT SHQIPTAR PËR EDUKIMIN FINANCIAR
- ZHVILLOHET TAKIMI I BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE ME DREJTUESIT E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT.
- ZHVILLON PUNIMET ONLINE ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E "INSURANCE EUROPE", PJESË E SË CILËS ËSHTË EDHE SHOQATA E SIGURUESVE TË SHQIPËRISË PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT DHE NËNKRYETARIT TË SIGURIMEVE TË EVROPËS.
- ZHVILLIMET KRYESORE TË TREGUT TË SIGURIMEVE TË JO-JETËS

Promovojmë praktikat dhe standartet më të larta në fushën e sigurimeve, në mbrojtje të interesave të konsumatorëve.

UZHVILLUA TAKIMI I-1 I TË IRRJETIT SHQIPTAR MBI EDUKIMIN FINANCIAR



Në datën 21.05.2021, nën kujdesin dhe drejtimin e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, dhe me prezencën e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe organizatave anëtare, u organizua takimi i 11-të (njëmbëdhjetë) i Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar (ANFE). Pjesëmarrësit në këtë takim virtual u ndalën dhe diskutuan mbi disa tema me interes për tregun financiar, të cilat përfaqësojnë kontributin e anëtarëve të Rrjetit në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit për edukimin financiar dhe përmirësimin e nivelit të tij në të gjitha shtresat e popullatës. Një vend të rëndësishëm në diskutime zuri inisiativa e Bankës së Shqipërisë për të hartuar një Strategji Mbarëkombëtare për Edukimin Financiar, inisiativë e cila është mirëpritur nga ANFE dhe anëtarët e saj janë angazhuar të kontribuojnë maksimalisht për ta bërë këtë



strategji sa më gjithëpërfshirëse dhe me ndikim sa më të gjërë në shtresat e popullatës. Në këtë drejtim pati edhe disa prezantime dhe ndërhyrje nga ekspertë ndërkombëtarë, të cilët sollën eksperiencën e tyre në këtë drejtim, të aplikuar në vende të tjera.

Për informacionin e Rrjetit dhe të anëtarëve të tij, nga Shoqata e Siguruesve u bë një prezantim për

Ligjin e ri Nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", miratuar së fundmi nga Kuvendi i Shqipërisë dhe risitë që ai sjell si një hap i rëndësishëm drejt përafërimit legjislativ me standartet europiane.

Pjesëmarrësit ofruan diskutime konstruktive dhe dhanë kontribut të rëndësishëm në hartimin e plan veprimit në lidhje me rolin e Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar në vijimësi, qoftë në drejtim të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar, si edhe në drejtim të aktiviteteve të planifikuara përgjatë vitit.

Për më shumë klikoni linkun:

<http://ama.com.al/deklarate-per-media/>

TAKIMI I BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE ME DREJTUESIT E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT.

Në datën 15/06/2021 u zhvillua takimi i bordit AMF me shoqëritë e sigurimit. Në takim



u diskutua në lidhje me risitë dhe detyrimet që sjell ligji i ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", si edhe për ecurinë e tregut të sigurimeve pas vitit pandemik. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Ervin Mete u kërkoi drejtuesve të shoqërive të sigurimit marrjen e të gjitha masave të nevojshme për zbatimin e plotë dhe pa vonesa të ndryshimeve ligjore. Z. Mete kërkoi hartimin

e procedurave të brendshme për trajtimin e shpejtë të kërkesave, për dëshmipërblim në rastet e Raportit Evropian të Aksidenteve, pajisjen e të gjithë personave të siguruar me këtë formular, si edhe informimin e qytetarëve në lidhje me kushtet e reja të kontratës së sigurimit të detyrueshëm TPL bazuar në ndryshimet ligjore.

Për më shumë klikoni linkun:

<https://top-channel.tv/2021/06/15/drejtori-i-amf-u-kerkon-shoqerive-te-sigurimit-te-marrin-masa-per-zbatimin-pa-vonesa-te-ndryshimeve-te-ligjit-te-ri/>

ZHVILLIMET E TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021

PUNIMET E ASAMBLESË TË PËRGJITHSHME TË “INSURANCE EUROPE”, PJESË E SË CILËS ËSHTË EDHE “SHOQATA E SIGURUESVE TË SHQIPËRISË”



Në datën 02/06/2021 zhvilloi punimet online asambleja e përgjithshme e “Insurance Europe”, pjesë e së cilës është edhe Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë. Në këtë event, si përfaqësues të Shoqatës së Sigurimeve të Shqipërisë morën pjesë Z Avni Ponari Kryetari Shoqatës dhe Z. Edvin Libohova, Sekretari Përgjithshëm i saj. Asambleja e Përgjithshme e Sigurimeve të Evropës votoi unanimitisht për zgjatjen e mandatit të Z. Andreas Brandstetter si President edhe për tre vjet të tjera (2021-2023). Z Brandstetter është zgjedhur President i Insurance Europe në Maj të vitit 2018. Andreas i është bashkuar industrisë së sigurimeve në vitin 1997, në fillim si asistent i CEO-s së kompanisë UNIQA, duke u bërë më pas edhe anëtar i bordit të menaxhimit. Qysh prej vitit 2011 ai mban edhe pozicionin e kryetarit dhe CEO i UNIQA Insurance Group. Duke komentuar mbi rikonfirmimin e tij në krye të Insurance Europe, Z. Brandstetter tha: “Jam thëllësisht i nderuar që më kërkuan të vazhdoj në rolin tim si President i Insurance Europe. Shoqëria po përballë me sfida të mëdha dhe industria e sigurimeve ka një rol kryesor për luajtje në përballimin e këtyre sfidave.

Ne gjithashtu përballemi me një axhendë të tngjeshur ndryshimesh legislative për një sërë temash, ku tregu i sigurimeve do të përpiqet të kontribuojë, sic janë temat mbi ndryshimet klimaterike, katastrofat, axhenda dixhitale si dhe rishikimin e Solvency II. Prandaj, do të vazhdoj angazhimin tim për të siguruar që zëri ynë të dëgjohet në këto diskutime të rëndësishme.” Për më shumë klikoni linkun:

<https://www.insuranceeurope.eu/news/2341/andreas-brandstetter-reappointed-as-president-of-insurance-europe-sandro-panizza-elected-vice-president?s=08>

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-qershor 2021 kapën vlerën 8,866 milionë lekë, ose 17.53% më shumë se në periudhën janar-qershor 2020. Gjatë periudhës janar-qershor 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 467,511 me një rritje prej 7.48% krahasuar me periudhën janar-qershor 2020.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.34% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.65%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.68% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.32% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-qershor 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,742 milionë lekë, ose 8.3% më pak se në periudhën janar-qershor 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e konsiderueshme e dëmeve të tërmeteve përgjatë vitit 2020.

Gjatë periudhës janar-qershor 2021, dëmet e paguara bruto nga sigurimi motorik kapën vlerën 2,076 milionë lekë duke pësuar një rritje me rreth 51.13% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

<https://amf.gov.al/news.asp?id=32752>

TREGUESIT KRYESORË TË TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021			
Viti 2021		në mijë lekë	
	Janar - QESHOR 2020	Janar - QESHOR 2021	Ndryshimi në %
Primet e shkruara bruto	7,543,803	8,866,358	17,53
nga kjo:			
përgjegjësi motorrike ndaj palëve të treta	4,554,734	5,081,889	11.57
MTPL e brendshme	173	186	7.54
Kartoni Jeshil	517	1,266	144.94
Kasko	106	118	11.59
Dëmet e paguara gjithsej	4,080,727	3,742,031	8.3
Numri i kontratave të nëshkruara	434,968	467,511	7.48

Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

ANËTARËT E SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË

